

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Andy Carroll rrëfen për herë të parë sulmin seksual: "Ishte e frikshme edhe ta mendoja" Top Albania Radio
ADRESA	https://www.topalbaniaradio.com/andy-carroll-rrerefen-per-here-te-pare-sulmin-seksual-ishte-e-e-frikshme-edhe-ta-mendoja/
BURIMI	topalbaniaradio.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 20:03:57 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 19:48:29 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	6805d698c5d3c7d9d7bee3902e89db2d8fefb32ef059a6bcf8c73b1a56d54274
TEKSTI	15a5b6293536cfd8c736c470720cd684d6ef14c1ca6bf63d78f975a176b51e21
PAMJA	2198896414b2baa45d6cd0443295365a7e86e91c375770d9291008464a112e35

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	19a8386d07aa1c63f1290ab4388ad4249682b92c5dcf5201eef03265716334af
E MËPARSHMJA	—
RRËNJJA MERKLE	f25232b47d2959dc6146897981a0af4e37060d45058c64d9459ab0f54fd17f54
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/19a8386d07aa1c63f1290ab4388ad4249682b92c5dcf5201eef03265716334af>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Celebrities Gossip Showbiz

Andy Carroll rrëfen për herë të parë sulmin seksual: “Ishte e frikshme edhe ta mendoja”



Redaksia K

25 Shtator 2026



I sh-futbollisti i Newcastle United, Liverpool dhe kombëtares angleze, **Andy Carroll**, ka vendosur të flasë publikisht për një përvojë të rëndë që e kishte mbajtur private prej vitesh.

Në autobiografinë e tij të re, “Owning It”, 37-vjeçari tregon se në vitin 2021 ishte viktimë e një sulmi seksual në shtëpinë e tij, gjatë periudhës kur luante për Newcastle. Carroll kishte pasur të drejtën e anonimatit si viktimë, por tashmë ka zgjedhur vetë që ta bëjë publike historinë.





Sipas rrëfimit të tij, personi përgjegjës ishte një mik i ish-partneres së tij, i cili kishte shkuar në shtëpinë e futbollistit për të parë së bashku një ndeshje boksi. Carroll tregon se më vonë shkoi të flinte, ndërsa personi qëndroi në banesë.

Carroll shkruan se u zgjua gjatë natës dhe kuptoi se po sulmohej seksualisht. Pas incidentit, ai e nxori burrin nga shtëpia, ndërsa kur ai tentoi të rikthehej, Carroll e goditi dhe e la pa ndjenja. Më pas telefonoi policinë.

Në librin e tij, ish-futbollisti ka shkruar:

“ U sulmova seksualisht, ja, e thashë. Është e frikshme edhe ta mendosh dhe, deri tani, vetëm një pjesë e vogël e njerëzve e dinin për këtë.




Carroll tregon se vendimin për ta përfshirë historinë në autobiografi e mori vetëm në momentet e fundit, pas shumë diskutimesh me partneren e tij, Lou Teasdale.

“ Unë dhe Lou kaluam shumë kohë duke diskutuar nëse duhej ta përmendnim apo jo në këtë libër. E shmanga botuesin tim për kaq gjatë, saqë ndoshta ata menduan se isha tërhequr.

Ai shpjegon se arsyeja pse vendosi të fliste edhe dëshira që përvoja e tij të mund t'i ndihmonte njerëzit e tjerë që kanë kaluar situata të ngjashme.

“ Është e frikshme të flasësh për këtë, por më ka bërë njeriun që jam sot, po aq sa edhe gjërat e mira. Dhe nëse të folurit për këtë më ndihmon të paktën një person, atëherë ia ka vlejtur.

Personi që Carroll akuzoi u arrestua dhe më pas u përball me gjyqin. Ai u shpall fajtor për vepra seksuale dhe u dënua me tre vite burg. Gjithashtu u regjistrua në listën e personave të dënuar për vepra seksuale. Carroll dëshmoi gjatë procesit gjyqësor.



Ish-futbollisti e ka përshkruar procesin gjyqësor si një përvojë veçanërisht të vështirë.



Të dëshmoja në gjykatë ishte poshtëruese, e turpshme dhe absolutisht e tmerrshme.

Carroll tregon se pas ngjarjes, pasojat nuk mbetën vetëm te kujtimet e asaj nate. Përvoja ndikoi edhe në jetën e tij profesionale dhe në aftësinë për t'u përqendruar te futboli.



Ajo që më ndodhi ndikoi në çdo aspekt të jetës sime. Mendoja për të çdo ditë, duke e bërë të vështirë të përqendrohesha në çdo gjë tjetër, përfshirë futbollin... Trauma e asaj që më ndodhi nuk është zhdukur.

Carroll, i cili fitoi nëntë ndeshje me kombëtaren e Anglisë dhe luajti për disa prej klubeve më të njohura angleze, sot është pjesë e Dagenham & Redbridge, ku është edhe bashkëpronar.

Vendimi për të folur publikisht vjen vite pas ngjarjes dhe pas përfundimit të procesit gjyqësor.

Me publikimin e "Owning It", Carroll ka zgjedhur të ndajë një pjesë shumë personale të jetës së tij, për të cilën, siç tregon vetë, kishte folur vetëm me një rreth shumë të ngushtë njerëzish.

LAJME TË NGJASHME



I dehur i bërtiti dhe e ofendoi, ish-futbollisti i njohur pajtohet me të dashurën!

MË TË LEXUARAT



Arrestohet Susan Sarandon/Protestoi kundër Netanyahu-t në OKB!



Lonely Planet zbulon destinacionet më të mira për 2027-ën!



Nations League, Kosova debuton me fitore!



Italia ndalon burkën në shkolla/Kufizime edhe për nxënësit e huaj në klasa!



Parada Seksi e Yjeve: kush do të digjet nga dashuria këtë fundjavë!



Si i jep fund marrëdhënieve secila shenjë e zodiakut!



55-vjeçarit i nxjerrin nga barku ngjallën e gjallë pas një dite!



Në këtë vend mendojeni dy herë para se të dëgjoni muzikë me zë të lartë, do të gjobiteni!




Agim Ademi, mesazh emocionues pas fitores së "Dardanëve"!



Rama në Këshillin Europian të Korporatave: Paqja, kusht për zhvillimin ekonomik!

EDITORI SUGJERON



Melatonina apo L-Theanine?! Ja cili suplement mund të ndihmojë më shumë me gjumin...



Një ilaç i ri për kancerin e pankreasit mund t'u japë pacientëve më shumë kohë!




"Një politikan, vajza e Alfred Cakos dhe..."/ Bledi Mane zbulon banorët e këtij sezoni të BBV?




A vazhdon të jetë i virgjër? At Nikolla Xhufka tregon si vepron kur përballlet me tundimet seksuale: Edhe tani me vajza të bukura...



"Më bezdis përndjekja..."/Ina Aderi: Më kanë ngacmuar personazhe, do dashurohem larg kamerave...




Kuqezinjtë nisin misionin e ri në Nations League, të gjitha emocionet live dhe ekskluzivisht në DigitAlb!




Pse na mungon dikush më shumë gjatë natës? Ja çfarë mund të fshihet pas kësaj ndjesie...



Mund t'u mungosh shumë, por mesazhin mos e prit! 3 shenjat e horoskopit që nuk bëjnë kurrë hapin e parë...



Fenomeni "pocketing"/ Kur partneri të mban sekret dhe askush në jetën e tij nuk e di që ekziston...



Pse disa njerëz ecin nëpër shtëpi ndërsa flasin në telefon? Arsyeja pse e bëjnë këtë pa e kuptuar është...

RRETH NESH

Top Albania Radio promovon muzikën më të zgjedhur shqiptare dhe të huaj, me edicionet informative dhe një larmi programesh kulturore. 27 vjet transmetim, për të dhënë më të mirën.

KONTAKT

Address: Sheshi Italia 1, Arena Center, Tirana, Albania

Email:

Tel: +355 69 208 0500

+355 69 442 8873

COPYRIGHTS

Përmbajtja e këtij website është pronë e Top Albania Radio. Kopjimi, përdorimi apo riprodhimi i paautorizuar i tij, përbën shkelje penale.

LINKS

[Kontaktimi](#)

[Marketing](#)

[Frekuencat](#)

[Aksesueshmëria](#)

[Mundësi Punësimi](#)

[Privacy Policy & Terms](#)



TOP ALBANIA RADIO

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.